




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në bazë të nenit 12, 17 dhe nenit 18 paragrafi 18.1 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 9,17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, duke u bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.020-513/5 datë 17.06.2021 dhe në shkresën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.22112/21 datë 15.06.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2021, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15NR.30-30026 PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË SEGMENTEVE RRUGORE "AFRIM ZHITIA", "MBRETI ZOG" DHE "KONGRESI I BLINAJËS" NË LIPJAN

Neni 1

1.ANULOHET Vendimi 15Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitia", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi i Blinajës" në Lipjan, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 03.06.2021.

2.OBLIGOHET Kryetari i Komunës të vazhdojë procedurat e shpronësimit konform nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.91/10 Dhjetor 2010.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008.

Arsyet e anulimit të Vendimi të cekur janë si vijon:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në shkresën përcjellëse nr. 020-513/5 e datës 17.06.2021 dhe në shkresën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.22112/21 datë 15.06.2021, të pranuar nga Komuna me datë 17.06.2021 ref.1nr.020-32900, është njoftuar Komuna e Lipjanit se Vendimi 15Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitia", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi i Blinajës" në Lipjan, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 03.06.2021, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke konstatuar: Komunitet me nxjerrjen e vendimeve për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësim janë duke bërë punë të dyfishtë sepse sipas ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme kompetent për kryerjen e procedurës së shpronësimit është vetëm Kryetari i Komunës i cili sipas këtij ligji është Organ Shpronësues sipas nenit 4 paragrafi 2 të ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme.

Komuna e Lipjanit të gjitha procedurat e shpronësimit konform legjislacionit në fuqi që janë bërë që nga viti 2018-2020 dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, që për se cilin vendim është konfirmuar ligjshmeria nga Ministritë përkatëse, dhe më pas Kryetari i Komunës si Organ Shpronësues ka zhvilluar procedurat e mëtejme.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

1Nr. 1-011-33181
Lipjan, më 18.06 2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Pranuar më: Primljeno: 17.06.2021		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-020-	32900	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI	
Përmes:		
Nga:	Zv. Trim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL	Datë: 16/06/2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-513/4
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	


I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 15Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmrive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitia", "Mbreti Zog" dhe Kongresi i Blinajës " në Lipjan, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komuna
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Izedin Bytyqi, Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarë përgjegjës: Zyrtari i konfirmues i vlerësimit ligjor Zyrtari i hartues i vlerësimit ligjor	
Lloji i aktit:	Vendimi 15 Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e paluajtshmerisë në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitla", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi i Blinajes", miratuar nga KK Lipjan.

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.10/2012 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, kompetencës ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Shprehjen I pika 10 të Rregullores së Qeverisë (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L 040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Vendimi 15 Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e paluajtshmerisë në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitla", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi i Blinajes", miratuar nga KK Lipjan.
I miratuar me datë: 03.06.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 04.06.2021

I dërguar për shqyrtim në MMPHI, me datë: 08.06.2021

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi 15 Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e paluajtshmerisë në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhiti", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi Blinajes", miratuar nga KK Lipjan.	- Komunat me nxjerrjen e Vendimeve për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësim janë duke bërë punë të defektuara sepse sipas Ligjit për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme, kompetencën për kryerjen e procedurës së shpronësimit është vetëm Kryetari i Komunës i cili sipas këtij Ligji është organ shpronësues sipas nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit për shpronësim të Pronës së Paluajtshme. - Pjesë e këtij vendimi ish edhe një pronë shoqërore për të cilën Kryetari i Komunës si Organ Shpronësues nuk ka kompetencë për shpronësim të kësaj pronë sepse sipas nenit 44 të Ligjit për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme, vetëm Qeveria e Kosovës mund të bëjë shpronësimin e ish pronave shoqërore që janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. - Andaj edhe pse Komunitet sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale kanë të drejtë me nxjerr Vendime për funksionimin brenda Komunës nxjerrja e këtyre vendimeve është e panevojshme sepse në vend të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës ka mundur që të miratojë Vendimin për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim sepse edhe pas këtij Vendimi, Kryetari duhet të miratojë - Vendimin për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim 1. Të caktojë dhe të ribajë Dëgjimin Publik

			2. Vendimin Preliminar për ligjshënimin e procesit të shpronësimit 3. Vendimin Përfundimtar i cili përmban shumën e kompensimit • Të gjitha këto akte duhet të nënshkruhen vetëm nga Kryetari i Komunës dhe duhet të shpallen në Gazetë Zyrtare dhe Ditore.
--	--	--	---

E bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës i propozon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshëm në lidhje me këtë vlerësim.